



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1848/4 prot

Datë 29.08.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 829/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2023 me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr.REF-75648-07-20-2023, me objekt “Blerje tonera”, me fond limit 3,767,083 (tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.07.2023 nga autoriteti kontraktor Identitek SH.A.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK  
Kodër Kashar, Autostrada Tiranë Durrës, Km 8, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Identitek SHA  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Ministria e Brendshme, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020

*“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 21-07-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr.REF-75648-07-20-2023, me objekt “*Blerje tonera*”, me fond limit 3,767,083 (tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.07.2023 nga autoriteti kontraktor Identitek SH.A.

II.2. Në datën 27.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në sistemin e ankesave elektronike është administruar ankesa me nr. ankimi elektronik A/2023/3315 protokolluar me nr. 1848/2023 protokollin, e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me përmbajtje si më poshtë vijon:

*[...]Së pari kërkesa e autoritetit kontraktor për të vendosur në ambalazh etiketa, në të cilat të jenë të pasqyruara në cdo rast, pulla e sigurisë, specifikimet teknike të kërkuara dhe treguesit kryesor fiziko kimik është një kërkesë e ekzagjeruar, e pamundur për tu realizuar dhe që nuk varet nga vullneti i operatorit ekonomik ofertues.*

*Sqarojmë se, etiketa dhe të dhënat që përcaktohen në të, janë një zgjedhje dhe një e drejtë të cilën e ka vetëm prodhuesi. Vendimi nëse, në etiketat e tonera do të jenë të përcaktuara pulla e sigurisë, specifikimet e kërkuara dhe treguesit kryesor fiziko-kimik të produktit toner, është vetem e prodhuesit të tonerit. Ne si tregues të tonerave nuk mund të detyrojmë prodhuesit të vendosin pulla sigurie në etiket apo edhe ne të gjithë ambalazhin e produktit. Apo për me tepër të përcaktojnë në etiketën e tonerave specifikimet e kërkuara dhe treguesit kryesor fiziko-kimik të tyre. Gjithashtu tonerat nuk janë produkte me rrezikshmeri për njeriun dhe për aq kohë sa nuk hyn në gamën e produkteve me rrezikshmeri nuk mund të përmbajne në etiketën e tyre tregues fiziko - kimik. Prandaj këto kërkesa dalin jashtë kompetencave tona. Autoriteti juaj kontraktor nuk mund të vendosë një kërkesë apo të vlerësojë një ofertues për kritere që nuk janë as kompetence, as e drejte e jona si OE. Për me tepër ju sjellim në vëmendje se pulla e sigurie nuk është element i cili përcaktohet si i detyrueshem nga ndonjë standard i aprovuar çilesie, në mënyrë që të garantojë çilesi të produktit. Ky element, nuk ndikon në çilesinë apo në funksionalitetin e tonerave dhe për pasojë prezencë apo mungesë e pulles në ambalazh apo edhe në etikete, sic kërkohet nga ana juaj, nuk jep asnjë garanci që produkti do të jetë me funksional apo me çilesor. Ka raste për me tepër që edhe prodhues të pajisjeve, kanë zgjedhur të mos aplikojnë ndonjë pulle sigurie për tonerat e prodhuar prej tyre, si p.sh Toshiba, Xerox për një pjesë modele tonerash.*

*Gjykuar sa me sipër, lutemi shtoni dhe togfjalëshin në rastet kur aplikohet nga prodhuesi në lidhje me pullën e sigurie, pasi në mënyrën se si është kërkuar nga ana juaj, përjashtohet një numër i konsiderueshem prodhuesish, të cilët kanë standardet e tre të ambalazhimit, të ndryshme nga kërkesat e përcaktuara nga ju, por gjithnjë, duke plotësuar të gjitha kërkesat dhe standardet e çilesisë[...].*

*“[...] Gjithashtu afati 10 ditor për levrimitin e mallrave të përcaktuar nga AK, në dokumentet standarde të tenderit lidhur me këtë procedurë prokurimi nuk është i mjaftueshem për realizimin në kohë dhe me çilesi të objektit të prokurimit duke patur në konsideratë edhe sasine të konsiderueshme të mallit që është objekt procedurë. Lidhur me sa më sipër gjykojmë se AK, duke qenë se ndodhemi para një marrëveshjeje kuader duhet të parashikojë një afat më të gjatë lidhur me levrimitin e mallrave për minikontraten e parë me të paktën 30 ditë, duke pasur në vëmendje volumin e kontratës me qëllim garantimin e furnizimit me mallra sipas specifikimeve teknike dhe njëkohësisht duke i dhënë mundësi ofertuesve kohën e nevojshme për të siguruar mallin sipas dokumenteve të procedurës së prokurimit. Pretendimet dhe kërkesat tona janë në përputhje të plotë me qëllimin e ligjit dhe me parimet e përcaktuara më sipër në legjislacionin e prokurimit publik dhe për me tepër nxitin dhe rrisin numrin dhe pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike në procedurat e prokurimit publik, duke sjelle konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.*

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesit, adresën dhe NUIS-in; b) të

dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesve.

II.4. Në përfundim të afatit brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në përputhje me nenin 114 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1848/2 prot., datë 02.08.2023, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike së bashku me procesverbalet e argumentuara për secilin kriter kualifikimi dhe specifikimi teknik, si dhe të jepet informacion i hollësishëm, lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “*Infosoft Office*” SHPK.

II.5 Me anë të shkresës nr. 1848/3 prot., datë 21.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik ka ridërguar kërkesën me lëndë “Rikërkesë mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK”, duke kërkuar i autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike, së bashku me procesverbalet e argumentuara për secilin kriter kualifikimi dhe specifikimi teknik, si dhe të jepet informacion i hollësishëm, lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “*Infosoft Office*” SHPK.

II. 6 Nga ana e autoritetit kontraktor nuk ka asnjë përgjigje në lidhje me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK

### III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Përpara shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimes, KPP sqaron, se duke qenë se edhe pas kërkesave për informacion të KPP-së drejtuar autoritetit kontraktor, nga ana e këtij të fundit nuk është dërguar asnjë informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt-ankimi, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 114 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës, KPP do të shqyrtojë kryesisht pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me argumentimin se: “Së pari kërkesa e autoritetit kontraktor për të vendosur në ambalazh etiketa, në të cilat të jenë të pasqyruara në cdo rast, pulla e sigurisë, specifikimet teknike të kërkuara dhe treguesit kryesor fiziko kimik është një kërkesë e ekzagjeruar, e pamundur për tu realizuar dhe që nuk varet nga vullneti i operatorit ekonomik ofertues.

Sqarojmë se, etiketa dhe të dhënat që përcaktohen në të, janë një zgjedhje dhe një e drejtë të cilën e ka vetëm prodhuesi. Vendimi nëse, në etiketat e tonera do të jenë të përcaktuara pulla e sigurisë, specifikimet e kërkuara dhe treguesit kryesor fiziko-kimik të produktit toner, është vetëm e prodhuesit të tonerit. Ne si tregues të tonerave nuk mund të detyrojmë prodhuesit të vendosin pulla sigurie në etiket apo edhe në të gjithë ambalazhin e produktit. Apo për më tepër të përcaktojnë në etiketën e tonerave specifikimet e kërkuara dhe treguesit kryesor fiziko-kimik të tyre. Gjithashtu tonerat nuk janë produkte me rrezikshmeri për njeriun dhe për aq kohë sa nuk hyn në gamën e produkteve me rrezikshmeri nuk mund të përmbajnë në etiketën e tyre tregues fiziko - kimik. Prandaj këto kërkesa dalin jashtë kompetencave tona. Autoriteti juaj kontraktor nuk mund të vendosë një kërkesë apo të vlerësojë një ofertues për kritere që nuk janë as kompetence, as e drejtë e jona si OE. Për më tepër ju sjellim në vëmendje se pulla e sigurisë nuk është element i cili përcaktohet si i detyrueshëm nga ndonjë standard i aprovuar çilesie, në mënyrë që të garantojë çilesi të produktit. Ky element, nuk ndikon në çilesinë apo në funksionalitetin e tonerave dhe për pasoje prezencë apo mungesë e pulles në ambalazh apo edhe në etikete, sic kërkohet nga ana juaj, nuk jep asnjë garanci që produkti do të jetë me funksional apo me çilesor. Ka raste për më tepër që edhe prodhues të pajisjeve, kanë zgjedhur të mos aplikojnë ndonjë pulle sigurie për tonerat e prodhuar prej tyre, si p.sh Toshiba, Xerox për një pjesë modelesh tonerash.

Gjykuar sa me siper, lutemi shtoni dhe togfjalëshin në rastet kur aplikohet nga prodhuesi në lidhje me pullën e sigurisë, pasi në mënyrën se si është kërkuar nga ana juaj, përjashtohet një numër i konsiderueshëm prodhuesish, të cilët kanë standardet e tre të ambalazhimit, të ndryshme nga kërkesat e përcaktuara nga ju, por gjithnjë, duke plotësuar të gjitha kërkesat të standardet e çilesisë[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

#### **Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Mallrat duhet të dorëzohen të ambalazhuara si më poshtë:

- *Ambalazhimi të jetë në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mallrave gjatë transportimit.*
- *Ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë së produktit.*
- *Ambalazhet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme, të markueshëm e të etiketueshëm, të hapen kollaj, të kenë volume të përshtatshme përdorimi dhe etikë në paraqitje.*
- *Duhet të lexohen me vëmendje rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t'u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.*

***Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:***

- *Emri i produktit,*
- *Emri i markës prodhuese,*
- *Pulla e sigurisë<sup>1</sup>*
- *Specifikimet e kërkuara.*
- *Treguesit kryesor fiziko-kimik<sup>2</sup>.*

<b><i>Nr.</i></b>	<b><i>Emërtimi</i></b>	
<i>1.</i>	<i>HP ose ekuivalent</i>	<i>HP laserjet M 203 DN Black</i>
<i>2.</i>	<i>HP ose ekuivalent</i>	<i>Toner HP M201(83 A) Black</i>
<i>3.</i>	<i>Epson ose ekuivalent</i>	<i>Epson LQ - 350 Black</i>
<i>4.</i>	<i>HP ose ekuivalent</i>	<i>HP officejet 973 black XL</i>
<i>5.</i>	<i>HP ose ekuivalent</i>	<i>HP officejet 973 Cyan</i>
<i>6.</i>	<i>HP ose ekuivalent</i>	<i>HP officejet 973 Yelloë</i>
<i>7.</i>	<i>HP ose ekuivalent</i>	<i>HP officejet 973 Magenda</i>

***Afati i lëvrimit është 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës***

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”.*

III.2.4. Neni 37 “Etiketa”, i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *Kur autoritetet ose entet kontraktore prokurojnë punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, ata mund të kërkojnë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:*

*a) kërkesat e etiketës përfshijnë vetëm kriteret që lidhen me objektin e kontratës dhe janë të përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e punëve, furnizimeve ose shërbimeve që janë objekt i kontratës;*

*b) kërkesat e etiketës të bazohen mbi kriteret objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese;*

*c) etiketat të përcaktohen me një procedurë të hapur dhe transparente ku mund të marrin pjesë të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë organet qeveritare, konsumatorët, partnerët socialë, prodhuesit, shpërndarësit dhe organizatat joqeveritare; ç) etiketat të jenë të aksesueshme për të gjitha palët e interesuara;*

*d) kërkesat e etiketës të përcaktohen nga një palë e tretë, mbi të cilën operatori ekonomik që aplikon për etiketën nuk mund të ushtrojë ndikim vendimtar. Kur autoritetet ose entet kontraktore nuk kërkojnë që punët, furnizimet ose shërbimet të përmbushin të gjitha kërkesat e etiketës, ato tregojnë kërkesat e etiketës, të cilave u referohen. Autoritetet ose entet kontraktore, që kërkojnë një etiketë specifike, pranojnë të gjitha etiketat që konfirmojnë se punët, furnizimet ose shërbimet plotësojnë të gjitha kërkesat e barasvlershme të etiketës. Kur*

*është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti ose enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmeshin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti ose enti kontraktor.*

*2. Kur një etiketë përmesh kushtet e parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1, por përcakton edhe kërkesa që nuk lidhen me objektin e kontratës, autoriteti ose enti kontraktor nuk e kërkon etiketën si të tillë, por mund të përcaktojë specifikimin teknik, duke iu referuar specifikimeve të detajuara të asaj etikete, ose, kur është e nevojshme, pjesëve të tyre, që lidhen me objektin e kontratës dhe janë të përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e këtij objekti”.*

III.2.5. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, parashikon shprehimisht se:

*1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

*2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

*3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

*4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë, ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.*

*5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmeshin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor”.*



III.2.6. Referuar dispozitive ligjore të sipërcituara, konkretisht në interpretim të pikës 2, të nenit 44, të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, KPP gjykon, se me anë të kërkesës së mësipërme, qëllimi i autoritetit kontraktor ka të bëjë me detyrimin e operatorëve ekonomikë për të dorëzuar dokumentacionit provues në të cilin të jenë lehtësisht të verifikueshme të dhënat teknike të produkteve të ofruara, të dhëna që lidhen me emrin e produktit, markën prodhuese, pullën e sigurisë, specifikimet teknike të kërkuara, treguesit fiziko-kimik, të cilat në thelb vërtetojnë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e autoritetit kontraktor. Në rastin konkret autoriteti kontraktor ka kërkuar që etiketa me elementët përkatës të jetë e stampuar mbi ambalazhin e produktit. Me të drejtë ankimesit kundërshtojnë këtë kërkesë pasi mënyra si pasqyrohen të dhënat e produktit sikundër kërkuar në specifikimet teknike, është në diskrecion të vetë prodhuesit dhe jo të ofertuesve pjesëmarrës në procedurë. Kërkesa që etiketa të jetë në ambalazhin e produktit, kufizon ata prodhues, që elementët e kërkuar lidhur me produktin mund t’i kenë të pasqyruara në trupin e produktit dhe jo domosdoshmërit në ambalazhin e tyre. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kërkesën e përcaktuar në formularin e specifikimeve teknike duke lënë të hapur mundësinë e vendosjes së etiketës qoftë në ambalazhin e produktit ashtu edhe në trupin e tij mjafton që elementët që provojnë përputhshmërinë e produktit të ofruar me atë të kërkuar të jenë të pasqyruara në të.

Modifikimi i kërkesës së mësipërme objekt-shqyrtimi është i nevojshëm, pasi në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e mësipërme nuk është e përshtatshme për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve, kjo pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave teknike në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Infosoft Office” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me argumentimin se: *“[...] Gjithashtu afati 10 ditor për levrimin e mallrave i përcaktuar nga AK, në dokumentet standarde të tenderit lidhur me këtë procedurë prokurimi nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit duke patur në konsideratë edhe sasine e konsiderueshme të mallit që është objekt procedure. Lidhur me sa më sipër gjykojmë se AK, duke qenë se ndodhemi para një marrëveshjeje kuader duhet të parashikojë një afat më të gjatë lidhur me levrimin e mallrave për minikontraten e pare me të pakten 30 dite, duke pasur në vëmendje volumin e kontrates me qëllim garantimin e furnizimit me mallra sipas specifikimeve teknike dhe njekohesisht duke i dhënë mundësi ofertuesve kohën e nevojshme për të siguruar mallin sipas dokumenteve të procedurës së prokurimit. Pretendimet dhe kërkesat tona janë në përputhje të plotë me qëllimin e ligjit dhe me parimet e përcaktuara me sipër në legjislacionin e*

prokurimit publik dhe për më tepër nxitin dhe rrisin numrin dhe pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike në procedurat e prokurimit publik, duke sjelle konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,

III.3.1. Në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafiku i lëvrimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë :

### **Shtojca 6**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>		<b>Njësia</b>	<b>Sasia e pritshme per 12 muaj</b>
1.	<b>HP ose ekuivalent</b>	<i>HP laserjet M 203 DN Black</i>	<i>Copë</i>	<i>1,349</i>
2.	<b>HP ose ekuivalent</b>	<i>Toner HP M201(83 A) Black</i>	<i>Copë</i>	<i>20</i>
3.	<b>Epson ose ekuivalent</b>	<i>Epson LQ - 350 Black</i>	<i>Copë</i>	<i>30</i>
4.	<b>HP ose ekuivalent</b>	<i>HP officejet 973 black XL</i>	<i>Copë</i>	<i>10</i>
5.	<b>HP ose ekuivalent</b>	<i>HP officejet 973 Cyan</i>	<i>Copë</i>	<i>10</i>
6.	<b>HP ose ekuivalent</b>	<i>HP officejet 973 Yelloë</i>	<i>Copë</i>	<i>10</i>
7.	<b>HP ose ekuivalent</b>	<i>HP officejet 973 Magenda</i>	<i>Copë</i>	<i>10</i>

**Afatet e lëvrimit: 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës**

III.3.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.3.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:  
“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.  
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.  
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.3.4. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në rastin konkret nga ana e ankimuesit kërkohet rritja e afatit të lëvrimit, pasi përcaktimi në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankim sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor për afatin e lëvrimit të mallrave, 10 ditë nga nënshkrimi i kontratës, është jo i mjaftueshëm për lëvrimin e mallit në kohë dhe cilësi sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

III.3.6. Sa më sipër, KPP referuar pretendimeve të ankimesit se periudha e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi nuk është e mjaftueshme për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të mallit që do të lëvrohet, volumit të kontratës, KPP gjykon, se afati i lëvrimit të mallit në rastin konkret duhet të rritet në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës, në mënyrë që ofertuesve t’ju lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallin, me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Për rrjedhojë, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e afatit të lëvrimit të mallit, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.4 KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me trajtimin e ankesës nga autoriteti enti kontraktor, sipas afateve të përcaktuara në nenin 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efijencës parashikuar në nenin 2 të LPP-së.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr.REF-75648-07-20-2023, me objekt “Blerje tonera”, me fond limit 3,767,083 (tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.07.2023 nga autoriteti kontraktor Identitek SH.A.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

